



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01Nr.61/01-31047/18
Kaçanik: 27.09.2018

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 27 Shtator 2018, pos tjerash, u :

INFORMUA

1. Me Aktivitetin e zhvilluar të DAK -Për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019, në bazë të dhënave të prezantuara në Informatën për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019 e hartuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

2. Pjesë përbërse e kësaj shkrese, është materiali më tekstin e mëtejme: "Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor, 2018/2019, e përmbledhur në gjithsej : 5 faqe / Lënda: 01Nr. 61/01-31047/18.

3. Më këtë Shkresë njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, dhe Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli

INFORMATË

Fillimi i Vitit të Ri shkollor 2018 /2019

Viti shkollor 2018-2019 ka filluar më 3 shtator 2018, sipas kalendarit shkollor të MASHT-it. Mësimi ka nis mbarë në të gjitha 12 shkollat fillore e të mesme të ulëta: SHFMU “Emin Duraku” dhe paralelet e ndara fizike në Runjevë, Gjurgjedell e Kërbliq, SHFMU “Idriz Seferi” – Bob me paralelet e ndara në Gajre e Kovaçec, SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë me paralelet në Vatë e Provoli, SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec dhe paralelen e ndarë në Nikaj, SHFMU “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër, SHFMU “Nazmi Osmani” në Elezaj e paralelen e ndarë në Bajnicë, SHFMU “Ali Asllani” në Doganaj, SHFMU “7 Shtatori” në Begracë, SHFMU “Dituria” në Ivajë dhe paralelen e ndarë në Strazhë, SHFMU “Naim Frashëri” në Kotlinë, SHFMU “Gafurr Luma” në Gllaboçicë dhe SHFMU “Agim Bajrami” në Stagovë. Kët ëvit shkollor, DKA sipas planit të punës dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë, ka marr vendim që nxënësit e 3 paraleleve të ndara fizike të vijnë në shkollat e tyre amë. Nxënësit e Llanishtes tani vijnë në skollën amë “Emin Duraku”, dhe ata të Koxhajve e Sllatinës në SHFMU “Ali Asllani” në Doganaj, ndërsa është siguruar transporti. Po ashtu, mësimi ka filluar edhe në ShMP “Feriz Guri e vëllezërit Çaka dhe në QEAP “Agimi”, me përjashtim të Gjimnazit “Skënderbeu” ku mësimi është shtyrë për shkak të renovimeve që janë bërë në objektin shkollor. Në Gjimnazin “Skënderbeu” është realizuar projekti “Masat e efijencës së energjisë” i financuar nga MZHE, në vlerë rreth 160 mijë euro që ka përfshirë rregullimin e kulmit të objektit, izolimin e mureve të jashtme dhe ndërrimin e të gjitha dritareve dhe dyerve kryesore; ndërsa krahas këtij projekti, edhe nga buxheti i Komunës është investuar në vlerë 15 mijë euro, projekti i cili ka përfshirë shtruarjen e dyshemesë me linoleum.

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK) edhe sivjet i ka filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2018/19.

Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve parafillor e fillor, ndërsa në bazë të raporteve të 12 shkollave fillore amë, këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 488 fëmijë në 27 klasa parafillore e 527 fates në klasat e para. Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka”. Në Gjimnazin “Skënderbeu” ishin planifikuar të regjistrohen gjithsej 288 nxënës në 9 paralele, ndërsa janë regjistruar 267 nxënës e ndërkaq, në SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 344 nxënës në gjithsej 11 paralele, ndërkohë që janë regjistruar 221 nxënës.

Sa i përket kuadrit arsimor, DAK gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit. Në disa nga pozitat është përsëritur konkursi pasi në afatin e rregullt nuk janë paraqitur kandidatë përkatës ose nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Janë bërë përpjekje edhe për përgatitjet higjienike e teknike dhe kryesisht të gjitha shkollat kanë qenë të përgatitura në këtë aspekt për fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019.

Para fillimit të vitit të ri shkollor janë kryer edhe shumë renovime të objekteve shkollore, ndërkaq në disa prej tyre vazhdojnë të kryhen edhe disa punime të mbetura, por që nuk pengojnë procesin mësimor.

Renovime janë bërë në:

SHFMU “Jusuf Gërvalla” në Biçec. Në objektin e shkollës është rregulluar aneksi shkollor (hapësira ku është vendosur kalldaja e ngrohjes), ndërsa në shkollën e fshatit Nikaj (paralele e ndarë e SHFMU “Jusuf Gërvalla”) është renovuar kulmi, fasadimi e izolimi i pjesës së objektit të vjetër dhe rrethoja e oborrit shkollor. Në shkollën e fshatit Runjevë (paralele e ndarë e SHFMU “Emin Duraku”) është bërë rregullimi i oborrit dhe është ndërtuar fusha sportive e ndërkaq në shkollën e Bajnicës (paralele e ndarë e SHFMU “Nazmi Osmani”) është ndërtuar aneksi shkollor dhe fusha sportive. Të gjitha këto projekte të realizuara në shkollat e lartëpërmendura janë financuar nga MASHT në vlerën e përgjithshme prej 73,000 euro.

Investime për rregullimin e objekteve shkollore janë bërë edhe nga buxheti i Komunës në shumën e përgjithshme prej 35,768 euro: Në SHFMU “Emin Duraku” në objektin e vjetër është planifikuar të riparohen shkallët e hyrjes dhe rregullimi i sallës së edukatës fizike. Në SHFMU “Idriz Seferi” në Bob, në shkollën amë është shtruar me linoleum dysHEMEJA e klasave e po ashtu me linoleum është shtruar edhe dysHEMEJA e klasave në SHFMU “Qamil Ilazi” në Kaçanik të Vjetër (objekti në Fushë të Pajtimit). Në SHFMU “Ali Asllani” në Doganaj është rregulluar salla e arsimitarëve dhe nyjeve sanitare, ndërsa në shkollën 4 klasëshe të Provolisë (SHFMU “Kadri Zeka”) është bërë ndërrimi i dritareve, lysterja e brendshme e objektit dhe rregullimi i nyjeve sanitare. Në objektin e SHFMU “Agim Bajrami” në Stagovë janë ndërruar dyert e klasave të pjesës së vjetër të shkollës dhe është shtruar me linoleum dysHEMEJA, ndërkohë që është rregulluar edhe një pjesë e trotuarit, ndërsa në Shkollën e Kotlinës janë rregulluar nyjet sanitare. Nga buxheti i Komunës është intervenuar edhe në dy objektet e shkollave të mesme: Në SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” janë rregulluar mekanizmat e dritareve dhe janë meremetuar nyjet sanitare, ndërkaq në Gjimnazin “Skënderbeu” janë shtruar dysHEMETË e klasave me linoleum.

Vlenë të përmendet se në Gjimnaz, shkak i punimeve mësimi është shtyrë fillimisht për dy javë e pastaj edhe për javën e 3-të, ekskluzivisht për shkak të neglizhencës – moskryerjes së punimeve të kompanisë së kontraktuar.

Pjesë e përgatitjeve për vitin e ri shkollor kanë qenë edhe trajnimet e mësimdhënësve për zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës. Gjatë javës së fundit të gushtit, për 6 ditë me radhë janë trajnuar gjithsej 115 mësimdhënës duke përfshirë edhe drejtorët e shkollave dhe zyrtarët e DKA-së, në 5 fusha kurrikulare (Gjuhë dhe Komunikim, Matematikë, Shkenca të Natyrës, Shoqëria dhe Mjedisit dhe Mësimi Klasor). Vlen të theksohet se vitin e kaluar janë trajnuar mësimdhënësit e klasave parafilllore, të para, gjashta dhe dhjeta (Gjimnaz), të cilët sivjet do të vazhdojnë të zbatojnë programin e Kurrikulës së re në klasën e dytë, shtatë dhe njëmbëdhjetë (Gjimnaz) ndërsa sivjet janë përfshirë mësimdhënësit të cilët më parë nuk kanë ndjekur trajnimet e që sivjet do të punojnë me klasat e para, gjashta dhe dhjeta (Gjimnaz).

Edhe gjatë këtij viti shkollor, DKA ka bërë përpjekje për furnizimin me kohë të shkollave me materiale pedagogjike, ndërsa për shkak të disa gabimeve gjatë shtypjes së ditarëve të punës, shpërndarja në shkollë është bërë me disa ditë vonësë e po ashtu vonesa janë shkaktuar edhe në shpërndarjen e librave të cilat edhe për këtë vit shkollor, qeveria e vendit (MASHT), përmes shtëpive botuese të kontraktuara, i ka furnizuar falas nxënësit e dy niveleve, I-V dhe VI-IX.

Në bazë të të dhënave, në shkollat e Komunës sonë kemi këtë gjendje statistikore:

Në nivelin 0 (parafillor) sivjet janë regjistruar gjithsej 488 fëmijë të shpërndarë në gjithsej 27 paralele duke përfshirë edhe dy paralele të reja, të hapura sivjet, në Runjevë e Strazh. Nëse e krahasojmë numrin e fëmijëve të regjistruar sivjet me ata të vitit të kaluar (494 fëmijë), atëherë del se sivjet në këtë nivel janë përfshirë 6 fëmijë më pak se vitin e kaluar. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti shkollor, ka filluar të zbatohet puna e edukatoreve me dy grupe fëmijësh, ashu sikur e saktëson edhe Udhëzimi Administrativ 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parafillore, që do të thotë se fëmijët e një paralele janë ndarë në dy grupe.

Në nivelin 1 (fillor), gjatë këtij viti shkollor mësimet janë duke i vijuar gjithsej 2545 nxënës që krahasuar me një vit më parë (2528), del se sivjet në këtë nivel janë duke vijuar 17 nxënës më shumë.

Tabela1. Numri i nxënësve nga klasa I deri V sipas shkollave

Shkolla	I	II	III	IV	V	Gjithsej
“Emin Duraku”	168	160	171	155	160	814
“Idriz Seferi”	49	65	47	40	68	269
“Kadri Zeka”	55	54	45	52	38	244
“Jusuf Gërvalla”	40	26	31	34	36	167
“Qamil Ilazi”	50	49	46	43	47	235
“Nazmi Osmani”	39	37	42	31	39	188
“Ali Asllani”	31	34	41	39	41	186
“7 Shatori”	38	31	37	27	39	172
“Dituria”	16	11	11	17	8	63
“Naim Frashëri”	8	5	9	7	6	35
“Agim Bajrami”	18	21	18	19	14	90
“Gafurr Luma”	13	15	18	21	15	82
Gjithsej	525	508	516	485	511	2545

Ndërkaq, në nivelin 2 (Mesëm të Ultë) nga klasa e VI deri në klasën e IX, mësimet sivjet i kanë filluar gjithsej 1982 nxëns apo 117 më pak, krahasuar me vitin shkollor 2017/2018 që në këtë nivel ishin gjithsej 2099 nxënës.

Tabela2. Numri i nxënësve nga klasa VI deri IX sipas shkollave

Shkolla	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
“Emin Duraku”	159	156	159	160	634
“Idriz Seferi”	47	62	64	53	226
“Kadri Zeka”	50	36	46	35	167
“Jusuf Gërvalla”	30	34	39	46	149
“Qamil Ilazi”	41	44	52	47	184
“Nazmi Osmani”	39	40	33	33	145
“Ali Asllani”	40	33	42	37	152
“7 Shatori”	23	37	36	39	135
“Dituria”	13	12	9	11	45
“Naim Frashëri”	6	4	7	7	24
“Agim Bajrami”	20	13	12	19	64
“Gafurr Luma”	15	20	12	10	57
Gjithsej	483	491	511	497	1982

Nga kjo që u tha më lartë, del se numri i përgjithshëm i nxënësve në të dy nivelet (1 dhe 2) fillor dhe të mesëm të ultë në këtë fillim viti shkollor është 4527.

Tabela 3. Numri i nxënësve nga klasa I deri IX sipas shkollave

Shkolla	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
“Emin Duraku”	168	160	171	155	160	159	156	159	160	1448
“Idriz Seferi”	49	65	47	40	68	47	62	64	53	495
“Kadri Zeka “	55	54	45	52	38	50	36	46	35	411
“Jusuf Gërvalla”	40	26	31	34	36	30	34	39	46	316
“Qamil Ilazi”	50	49	46	43	47	41	44	52	47	419
“Nazmi Osmani”	39	37	42	31	39	39	40	33	33	333
“Ali Asllani”	31	34	41	39	41	40	33	42	37	338
“7 Shatori”	38	31	37	27	39	23	37	36	39	307
“Dituria”	16	11	11	17	8	13	12	9	11	108
“Naim Frashëri”	8	5	9	7	6	6	4	7	7	59
“Agim Bajrami”	18	21	18	19	14	20	13	12	19	154
“Gafurr Luma”	13	15	18	21	15	15	20	12	10	139
Gjithsej	525	508	516	485	511	483	491	511	497	4527

Në tabelën Nr.3 shihet se numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë vit shkollor është 4527 që krahasuar me vitin shkollor paraprak 2017/18 (4627 nxënës) është më i vogël për 100. Edhe vitin e kaluar ishte konstatuar rënie e numrit të nxënësve për 167 në krahasim me vitin paraprak (2016/17). Përderisa gjatë vitit shkollor 2017-2018, numri i nxënësve ishte 4627, në vitin paraprak 2016/17 numri i tyre ishte 4794.

Në nivelin 3 (Mesëm të Lartë) në 2 shkollat e mesme, Gjimnazin “Skënderbeu” dhe SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” këtë vit shkollor 2018/2019 mësimet i vijnë gjithsej 1477 nxënës që krahasuar me një vit më parë (2017/2018) që ishin 1533 nxënës, sivjet janë regjistruar 56 nxënës më pak kurse vitin e kaluar shkollor ishin regjistruar 34 nxënës më pak krahasuar me vitin shkollor paraprak (2016/2017)..

Në Gjimnazin “Skënderbeu” numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar është 780 (vitin e kaluar 791) dhe në SHMP “Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” 694 (vitin e kaluar 742)

Tabela 4. Numri i nxënësve sipas klasave në 2 shkollat e mesme.

Shkolla	X	XI	XII	GJ
Gjimnazi "Skënderbeu"	267	233	283	783
SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka"	221	227	246	694
Gjithsej	488	460	529	1477

Me respekt,
Zahir Doda, drejtor i DAK

